




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEČAN



Drejtoria e Arsimit
Nr.07-Zyrtarisht
23.08.2021

Në bazë të nenit 5, shkonja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 17, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHT:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS PLOTËSUES (AFATI I GUSHTIT)

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT DHE SHKOLLËS SË MESME TEKNIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2021/2022

I. Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri" në Deçan

DREJTIMI: SHKENCA NATYRORE
NXËNËS

5x10 =50 nx.

DREJTIMI: SHKENCA SHOQËRORE – GJUHËSORE
NXËNËS

5x20 =100 nx.

Gjithsej: 150 nxënës

II. Shkolla Mesme Teknike "Tafil Kasumaj" në Deçan

TEKNOLOGJI E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

PROFILIET ARSIMORE:

TEKNIK I SISTEMEVE TE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
TELEKOMUNIKACION

6 nx.

7 nx.

MAKINERI

PROFILIET ARSIMORE:

AUTOMEKANIK
INSTALUES I NGROHJES E KLIMATIZIMIT DHE UJËSJELLËSIT
MEKATRONIKË

20 nx.

14 nx.

19 nx.

EKONOMI

PROFILIET ARSIMORE:

NËNPUNËS I KONTABILITETIT DHE TATIMEVE
TREGTI ME PAKICË DHE SHUMICË

12 nx.

13 nx.

SHERBIMET

PROFILIET ARSIMORE:

ASISTENT I GASTRONOMISË

19 nx.

SHËNDETËSI

SHENDETI DHE MIRËQENIA:

Bashkëpunëtor profesional i infermierisë

32 nx.

Gjithsej: 142 nxënës

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të Gjimnazit dhe të Shkollës së Mesme Teknike, për vitin shkollor 2021/2022, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët kanë mbaruar arsimimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën teknike, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Certifikatën e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnazin dhe shkollës së mesme teknike për vitin shkollor 2021/2022, bëhet më datën **23, 24 dhe 25 gusht 2021** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohen duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallën në shkollat përkatëse më datën: 26.08.2021

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

AFATI I ANKESAVE

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit kanë të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqesin ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtja: Mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbjen e të drejtës për ankesë në shkollën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). DKA dhe MASHT nuk i shqyrtojnë asnjë ankesë nëse ajo nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës

Drejtori i DKA-së:

Ma.sc. Bekim Vishaj

